



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 07.05.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 06.05.2019 të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: "Marimanga" shpk;NTSH. "MARIMANGA" nga Prishtina**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Sherbimet e transportit me marimange** me Nr. të Prok: **616-18-8971-2-1-1** dhe numër te brendshëm **616 18 069 211** nxjerr:

VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e **Grup i Operatorëve Ekonomik: "Marimanga" SHPK & NTSH. "MARIMANGA" nga Prishtina** të dt. 06.05.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit **Sherbimet e transportit me marimange**, me Nr. të Prok: **616-18-8971-2-1-1** dhe numër te brendshëm **616 18 069 211**, kundër *Njoftimit për tenderuesin e eliminuar*, të datës 25.04.2019.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit per tenderin Sherbimet e transportit me marimange*, me Nr. të Prok: **616-18-8971-2-1-1** dhe numër te brendshëm **616 18 069 211**, sipas Njoftimit për dhenje te kontratës me datën: 25.04.2019.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Grup i Operatorëve Ekonomik: "Marimanga"SHPK & NTSH. "MARIMANGA" nga Prishtina me datë 06.05.2019, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Sherbimet e transportit me marimange**, me Nr. të Prok: **616-18-8971-2-1-1** dhe numër te brendshëm **616 18 069 211**. Autoriteti Kontraktues, me datë 25.04.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues ju njofton se kerkesa juaj per rishqyrtim eshte e paraqitur pas afatit te parapar me LPP dhe me rregullat dhe Udhezuesin e prokurimit publik.

Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit kontraktues eshte ngritur ne pltaformen e E-Prokurimit me daten 25.04.2019, keshtu qe kane kaluar pesë (5) ditet e parapara per paraqitjen e kerkeses per rishqyrtim.

AK, ka bere vleresimin e ofertave gjithnje duke u mbeshtetur ne LPP dhe ne Rregullat e Udhezuesit Operativ per prokurim Publik.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'A. Armani', written over a horizontal line.

Zyrtari përgjegjës i Prokuri+mit